



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/284

Datë: 19.08.2020

Procesverbal

i mbledhjes së V (e pestë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -III- dhe mbledhjes së -IV- të KPF-së.
2. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës sipas kërkesës nr.01/621 datë: 03.07.2020 të parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Ekoregjioni" sh.a. Prizren, për bartjen e pronës publike e cila është në emër të KK-Malishevë, e njëjta të jepet në shfrytëzim të mëtejme apo të bartet në pronësi të kësaj kompanie publike regjionale, përkatësisht njësisë në Malishevë.
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës sipas kërkesës nr.01/615 datë: 03.07.2020, e parashtruar nga përgjegjësi i N.T.P "ILI" me seli në fshatin Banjë KK-Malishevë.
4. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor financiar nga Kryetari i Komunës për vitin 2020.
5. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2020.
6. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2020.
7. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2019.
8. Shqyrtimi i kërkesave.
9. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 21.07.2020 duke filluar në ora 11:00, morën pjesë 4 anëtarë të KPF, zyra për informim.

Raimonda Krasniqi: Ju përshëndes të gjithëve me kërkesë të kryesuesit të kuvendit sot do ta kryesoj këtë mbledhje pasi që ai është në pushim dhe ska mund sot ta udhëheqë këtë mbledhje. Mbledhja ka qenë e paraparë të mbahet ditën e Premte por ska pas kuorum. Rëndin e ditës e keni me material të mbledhjes.

Kush jeni për këtë rend të ditës për këtë mbledhje? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -III- dhe mbledhjes së -IV- të KPF-së.

Raimonda Krasniqi: Tani kemi dy procesverbale të mbledhjeve të kaluara, nëse s'keni diçka, kush jeni për miratimin e këtyre dy procesverbaleve? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës sipas kërkesës nr.01/621 datë: 03.07.2020 të parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Ekoregjioni" sh.a. Prizren, për bartjen e pronës publike e cila është në emër të KK-Malishevë, e njëjta të jepet në shfrytëzim të mëtejme apo të bartet në pronësi të kësaj kompanie publike regjionale, përkatësisht njësisë në Malishevë.

Alban Krasniqi: Qyteti po zgjerohet dhe ai vend aty nuk i plotëson kushtet, mirë ka qenë me gjete një zgjidhje për një lokacion tjetër, sepse ai vend aty si përshtatet as ndërmarrjes e as qytetit, tash me

larg është njësia e zjarrfikësve se sa kjo kompani. Mirë ka qenë me ju dhanë afat shtesë e me zhvendosë me një vend tjetër. Kjo duhet të ishte larg vendbanimit e jo larg infrastrukturës, pra njësia Ekoregjioni në Malishevë të zhvendoset prej aty të behët plan më afatgjatë për një lokacion tjetër. Hashim Vrenezi: Jam ta përcjellim këtë kërkesë për asamble edhe pse na vijnë kërkesa disa herë të kësaj forme.

Valon Krasniqi: Edhe unë jam që si kërkesë të përcillet për asamble.

Alban Krasniqi: Kërkesa duhet të jetë për caktim të një lokacioni të ri e jo meja zgjatë afatin njësisë aty.

Muharrem Morina: Në vitin 2005 bordi i drejtorëve ka nxjerrë vendim, e që atij vendimi i ka parapri një vendim i administratorit. Kuvendi tani mund të vendosë ose me ja zgjatë afatin ose me caktu lokacion me vendim. Ndoshta ka qenë mirë meja vazhdu afatin edhe për 10 vite e tani drejtoria për Gjeodezi me fillu me gjete mundësinë për caktim të lokacionit, sepse edhe më herët ka qenë kërkesa për pikë të transferim për mbeturina.

Hashim Vrenezi: Nëse s'është pikë transferi atëherë nuk është problem me ja vazhdua afatin.

Muharrem Morina: Një donacion që është fitu prej GIZ, shkak i lokacionit është rrezik me humb atë donacion.

Alban Krasniqi: Ky debat përcakton do hapa të ardhshëm, por shihet nevoja që kjo kompani mu zhvendos prej aty, me pas parasysh edhe vlerën e tokës ose investimi i objekteve tjera ku mundet mu ndërtuar, por aj objekt se ka vendin aty ku është tani. Nuk ka bazë ligjore për pika grumbulluese sipas ligjeve në fuqi, prona komunale po zvogëlohet e mos të kemi probleme. Pra kjo kërkesë t'i kthehet drejtorisë për Gjeodezi të ofron Informacion se a kemi prona alternative për caktim të lokacionit për zhvendosjen e përfaqësive për të dy kompanitë: Ekoregjioni dhe Hidroregjioni në një lokacion të ri.

Unanimisht ishin që kërkesa t'i përcillet kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Gjeodezi.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës sipas kërkesës nr.01/615 datë: 03.07.2020, e parashtuar nga përgjegjësi i N.T.P "ILI" me seli në fshatin Banjë KK-Malishevë.

Muharrem Morina: Kryetari ka parashtuar kërkesë sipas kërkesës së përfaqësuesit të kompanisë që këtij të fundit ti falet kësti prej 10.000 euro, pra kësti i parë për vitin 2020, pasi që aj nuk ka mund me operu për shkak të gjendjes së pandemisë dhe sipas vendimit të qeverisë që ka mbyllur pishinat.

Valon Krasniqi: Si kërkesë me duhet e arsyeshme.

Alban Krasniqi: Unë edhe atëherë kam qenë kundër kontratave të tilla, sepse për aq të hyra sa ne po kemi shumë lehtë ma mund me menaxhu sektori publik. Tash qysh e ka nënshkruar ai kontratën nëse aj fitimin e ka pas për dy muaj, tash gjysmën e kontratës nuk ta hjek askush.

Hashim Vrenezi: Edhe sot me duket e ka të ndaluar me punuar, por edhe nëse aji pishinë e ka pas të ndaluar me punu spe atëherë pse ujin se kanë zbrayë prej pishinës, kërkesa është e arsyeshme në mirë është mos mu ngute deri në fund të zezonës dhe tani me vendos si me falë me ndonjë formë të rimbursimit ose me gjete ndonjë zgjidhje.

Alban Krasniqi: Më herët kemi pas kërkesë për shkak të kushteve atmosferike tash jo për shkak të pandemisë dhe ne mirë është mos me përdore standarde të dyfishta.

Hashim Vrenezi: Mirë është ta kemi kontratën, nëse ka vendim të qeverisë me pa a janë kompensuar, një deklaratë prej tij, ndonjë faturë të pagesës për vitin 2019.

Alban Krasniqi: Nuk mund të falim më shumë se sa fale një individ privat.

Valon Krasniqi: Kërkesën duhet me trajtu ashtu qysh është parashtuar.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni me rekomanduar kërkesën për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor financiar nga Kryetari i Komunës për vitin 2020.

Hashim Vrenezi: Sipas këtij raporti shihet se këtë vit është punuar shumë pak, kanë neglizhuar çdo vit në investime kapitale. Nuk ka qenë mirë që kta mu thirr në pandemi e prej qershorit ska pas ndonjë pengesë pra janë raporte të rrejshme, ka projekte dy vjeçare e kta po i paguajnë projektet me

buxhetin e këtij viti. Ky është një keq menaxhim që në fund po e pësojnë qytetarët e tani edhe mjetet po shkojnë në suficit. Të një tabelë në raport shihet se vendime gjyqësore 356 mijë euro, pse kanë borxhe në shuma kaq të mëdha.

Alban Krasniqi: Këtë raport duhet ta paraqes kryetari e jo drejtori.

Hashim Vrenezi: Ka edhe gabime në raport, por pyetja është pse kanë ndodhë këto shpenzime të mëdha.

Alban Krasniqi: Duhet që për këtë raport kërkesë specifike, Informacion lidhur me vendimet gjyqësore, për ç'fare janë bërë ato shpenzime dhe lista kujt i janë bërë këto pagesa si dhe lista e vendimeve gjyqësore. Të silltet një listë për të gjitha projektet kapitale të cilat kanë qenë të planifikuara me buxhet, cilat projekte kanë përfunduar, cilat janë në proces e sipër dhe të kontraktuara e që s'janë zbatuar-devijuar. Informacione lidhur me vendimet e KPF-së dhe vendimet e Kryetarit të Komunës për pagesat e përfituesve për subvencione, në cilat raste janë paguar. Informacione lidhur me shpenzimet-pagesat për nënat lehona që janë bërë brenda 6 muajve të vitit 2020.

Me pas punu zyrtaret e Komunës me shumë deri në kushtetuese është dashtë me kerku e me mbrojte Institucionin.

Raimonda Krasniqi: Me gjitha këto pyetje për këtë raport kush jemi me rekomanduar për Kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2020.

Alban Krasniqi: Ky raport i mangët, shembull mirë ka qenë me dite sa vizita drejtorja ju ka bërë bujqve.

Hashim Vrenezi: Shihet se drejtori si përfille kategoritë buxhetore që I ka nda kuvendi, ska kurrfarë plani të punës. Ky raport të rekomandohet me vërejtje për Kuvend.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni të rekomandohet ky raport për Kuvend? Unanimisht ishin për.

6. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2020.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni të rekomandohet ky raport për Kuvend? Unanimisht ishin për.

7. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2019.

Alban Krasniqi: Një anëtar i komisionit është ndërruar tani kemi një anëtar të ri, ajo që vërehet është mungesa e informacioneve nga menaxhmenti i stacionit . Menaxheri aty ka dhënë dorëheqje dhe ndërmarrja veç se a futë në krizë, me vendim e kemi caktu bordin e përkohshëm ai punon pa kompensim. Vendimi i kuvendit s'është zbatuar, stacioni ka funksionuar pa dokumente, xhirollogarinë e ka të bllokuar, jemi mundu ta ndryshojmë Statutin dhe me pa kah kanë rrjedhë mjetet. Roli i kryetarit ka qenë destruktiv kemi kërkuar si komision bashkëpunim, stacioni vazhdon me mbete mbyll ka hezitim prej menaxherit të ri për shkak të presioneve prej tjerëve.

Hashim Vrenezi: Bordi a i dinë përgjegjësitë e veta që i ka, cilat punë i bënë ai, se bordi ka mujte me marrë edhe masa aty.

Alban Krasniqi: E mira është se anëtarët e bordit janë zgjedhë nga lista që kanë aplikuar, por ata kanë pengesa me kanë efikas. Me ndryshimin e statutit bordi duhet me punuar me një menaxher të ri edhe pse ndërmarrja është për toke. Nëse bordi se dërgon ne duhet me dërguar në prokurori.

Hashim Vrenezi: Jam që aty me kufjellë gjendjen në ndërmarrje ta kemi edhe Statutin.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni të rekomandohet kjo pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

8. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/256 datë: 17.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të asamblistëve nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë, lidhur me plotësimin e Komiteteve të përhershme dhe të përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës.

Alban Krasniqi: Ata duhet mi sjellë emrat për votim në asamble, ato dy vende tash aty njëri duhet me kanë prej AAK-së, po ashtu edhe në komisione njëri anëtar duhet me kanë prej AAK-së.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni të rekomandohet kjo kërkesë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/242 datë: 06.07.2020 të parashtruar nga z. Shemsi Mazreku nga Malisheva për ndërrimin e pronësisë.

Alban Krasniqi: Kërkesat e tilla duhet të vijnë prej kryetarit të Komunës.

Hashim Vrenezi: Me këtë kërkesë duhet mu marre drejtoria për Gjeodezi.

Muharrem Morina: Drejtoria për Gjeodezi duhet të bëjë një raport, historiat i pronës, duhet vlerësimi i të dy pronave pastaj kuvendi vendosë.

Hashim Vrenzi: Gjeodezia duhet të del në teren, të verifikoje, të bëjë konstatimin faktik të pronave dhe pas ekspertizës së bërë të përgatisë raport me shkrim.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet drejtorisë për Gjeodezi? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.012/82 datë: 16.07.2020 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport z.Rexhep Mazreku.

Valon Krasniqi: Ka shqetësime se shumë klube private po e shfrytëzojnë fushën e klubi Malisheva po ka problem.

Hashim Vrenezi: Si kërkesë e tillë a kanë me pas fushë ndihmese për ata duhet të caktohet lokacion.

Alban Krasniqi: Kjo kërkesë t'i kthehet drejtorisë për Kulturë ta sjellin Planin ideor, kostoja financiare për ndërtim të fushës-stadiumit ndihmës, informacion lidhur me donatorët, si dhe a është e paraparë sipas PZHK-së ndërtimi i kësaj fushe.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet drejtorisë për Kulturë me këto pyetje? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/237 datë: 03.07.2020 e parashtruar nga z.Manush Limaj nga fshati Banjë Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për shërim të bashkëshortes së tij znj. Hamide Limaj.

Alban Krasniqi: Kemi dhjetëra raste me dializë, ndihmën që ja japim ne duhet të specifikohet ne vendim për transplant të veshkës e jo kërkesa mu devijuar.

Hashim Vrenezi: Unë me sa di rastet e sëmundjeve kur ka kosta të mëdha i mbulon fondi sigurimeve shëndetësore.

Raimonda Krasniqi: Kush jeni që këtë kërkesë pas propozimeve ta mbështesim me 950 euro? Unanimisht të gjithë ishin për.

Raimonda Krasniqi: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

